

VENDIM
Nr. 854, datë 26.12.2024

PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË DISA KATEGORIVE TË VEÇANTA,
PËR VITIN 2024

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfitojnë mbështetje financiare për vitin 2024, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, përfituesit e ndarë sipas kategorive të mëposhtme:

a) familjet dhe individët që trajtohen me ndihmë ekonomike sipas nenit 7, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përfshirë edhe ata që përfitojnë nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike;

b) fëmijët pa kujdes prindëror të vendosur në familje kujdestare;

c) Personat me aftësi të kufizuara, sipas shkronjave “b” dhe “c”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

ç) individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar;

d) individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar;

dh) ndihmësit personale të përfituesve të pagesave të aftësisë së kufizuar, sipas shkronjave “c”, “ç” dhe “d”, të kësaj pike.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 2 166 525 000 (dy miliardë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e njëzet e pesë mijë) lekë dhe përballohen nga fondi për mbështetjen financiare për shtresat në nevojë, miratuar për vitin 2024.

3. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama